



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1706 Prot.

Tiranë, më 13.12.2021

LËNDA: Sugjerime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me Projektligjin “Për Regjistrin Kombëtar për të dënuarit për krime seksuale”.

ZNJ. KLOTILDA BUSHKA
KRYETARE
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT
KUVENDI I SHQIPËRISË

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4, Tiranë

Për dijeni:

ZNJ. LINDITA NIKOLLA
KRYETARE E KUVENDIT
KUVENDI I SHQIPËRISË

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4, Tiranë

Të Nderuar!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar¹, dhe në kuadër të ushtrimit prej tij, me statusin e institucionit të pavarur publik:

- ✓ të attributeve që i jepen prej Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, (i ndryshuar), për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ përmbushjes prej KMD-së të qëllimit të Ligjit Nr. 10 221/2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ zbatimit të nenit 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon se: “Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”,

¹Ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020 (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 191 datë 03.11.2020).

Në vijim të ftesës Tuaj për të dhënë mendim lidhur me projektligjin “Për Regjistrin Kombëtar të të dënuarve për Krime Seksuale”, hartuar nga CRCA/ECTAP, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parashtrohet në lidhje me Projektligjin, komentet si më poshtë vijon:

Së pari, Në nenin 21 (Kreu IV), pika 2 “*Dosja unike e personalizuar*”, propozojmë të shtohet e dhëna personale “amësia”, përsa kohë është e dhënë thelbësore për identifikimin e individit.

Në po këtë nen, pika 2 (Formulari A) shkronja “f” është parashikuar edhe termi “kombësi”. Propozojmë, që “kombësia” duhet hequr si element identifikimi, përsa kohë ky term është shfuqizuar nga regjistrat e gjendjes civile, me vendimin nr.52, datë 01.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

Së dyti, në nenin 33 “*Detyrimi për verifikim*”, me qëllim sigurimin e zbatimit të kësaj dispozite, në një pikë të fundit të këtij neni, të parashikohet penalitete në rast të moszbatimit të këtij neni ndaj autoritetit i cili ka detyrimin për verifikim,.

Së treti, në nenin 34, “*Të drejtat e të dënuarit për krime seksuale*”, krahas parashikimeve aktuale propozojmë të shtohen edhe dy pika të tjera të cilat garantojnë të drejtat e të dënuarit, si më poshtë :

“-E drejta e të dënuarit për t’u përfaqësuar me një avokat kryesisht në rast të pamundësisë ekonomike.

-E drejta për t’u mos diskriminuar për shkak të statusit të tij, përveç rasteve të justifikimit objektiv nga një synim i ligjshëm.”

Së katërti, në nenin 40 “*Kohëzgjatja e regjistrimit dhe dalja nga regjistri*”, parashikohet dalja nga regjistri në momentin e rehabilitimit. Në mënyrën si është konceptuar kjo dispozitë, humbet qëllimin për të cilin po krijohet Regjistri I Krimeve Seksuale. Në rast se një person nuk është rehabilituar për një vepër penale, kjo e dhënë rezulton edhe në gjendjen gjyqësore të individit e cila kërkohet nga punëdhënësi. Pra, në mënyrë që ky ligj të sjell një risi duhet që të ketë një dispozitë ku të parashikohet heqja e së drejtës për të ushtruar ato lloj profesione që lidhen në mënyre direkte me fëmijët, në mënyrë të përhershme, pavarësisht rehabilitimit sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

